

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6159  
E shtunë, 7 nëntor 2020  
çmimi 0.40 €

Osmani thotë se do të angazhohet për unifikimin e skenës politike | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VLERËSOHET LART BASHKËPUNIMI I THAÇIT, I VESELIT, I SELIMIT DHE I KRASNËQIT ME GJYKATËN SPECIALE | FAQE 4-5

## 'GJAHU' I SPECIALES, BASTISET SHTËPIA E THAÇIT, E VESELIT DHE E SELIMIT



Një ditë pas ngritjes së aktakuzës dhe dërgimit në Hagë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, hetuesit e Prokurorisë së Specializuar kanë bastisur shtëpitë e tyre. Hetuesit e Speciales kanë qëndruar për disa

orë në shtëpitë e ish-drejtuësve më të lartë të UÇK-së. Pavarësisht kësaj, ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së në Kosovë kanë vlerësuar lart bashkëpunimin e liderëve të Kosovës me Gjykatën

Speciale. Ata kanë thënë se i vlerësojnë lart fjalimet e Thaçit dhe të Veselit, të cilët kanë bërë thirrje për respektimin e procesit gjyqësor

### OPINION

TË MBROHEN VLERAT E LUFTËS SË SHENJTË TË UÇK-së | F. 10-11

Shkruan: Nuhi BYTYÇI



GJASHTË FAKTET QË NUK I MERR PARASYSH GJYKATA SPECIALE | F. 11

Shkruan: Adnan ASLLANI



### AKTUALE

VETERANËT E UÇK-së VENDOSIN PËR SHTYRJEN E PROTESTËS, KËRKOJNË PEZULLIMIN E DIALOGUT ME SERBINË | F. 3

DISKUTOHET PËR LIGJIN E TË PAGJETURVE | F. 6

KOSOVA MBYLLET NË FUNDJAVË PËR MBROJTJE NGA PANDEMIA | F. 7

### EKONOMI

BLLOKIMI I XHIROLLOGARIVE, PUNËTORËT E TELEKOMIT I JAPIN ULTIMATUM QEVERISË DERI TË HËNËN | F. 9

DËSHTON SEANCA PËR PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE | F. 9

SHKARKOHET KRYESHEFI I KOSTT-it | F. 8



Hoxhaj: Lufta e UÇK-së ishte e pastër, Veseli e Thaçi u sollën si burrështetas | FAQE 3

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë sjellë si burrështetas pas ngritjes së aktakuzës nga Gjykata Speciale. Në një

konferencë për media, ai ka deklaruar se ata ishin në lartësinë e burrështetasve të rrallë, që përpara interesit të Kosovës e vendosën çdo interes tjetër. Hoxhaj ka bërë thirrje për maturi dhe bashkim

Koronavirusi, i ashpër në Kosovë | FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# “Decision Desk”: Bideni është presidenti i 46 i ShBA-së

WASHINGTON, 6 NËNTOR - Avokati i ekipit elektoral të presidentit Donald Trump, Matt Morgan, në një shkrim publikuar në “Twitter”, ka thënë se “parashikimi fals i fitores së Joe Bidenit bazohet në rezultatet e katër shteteve ku shifrat janë larg të qenit përfundimtare”. Në Xhorxhia ai ka thënë se “do të ketë rinumërim”, duke shprehur besimin se do të gjenden pasaktësi që do t’ia japin fitoren presidentit Trump. Në Nevada, ka thënë avokati i ekipit elektoral, “ka dyshime se mijëra vota me postë janë të paligjshme”. Avokati Matt Morgan ka thënë se Trumpi do të fitojë në Arizona, përkundër parashikimeve të

gabuarra të rrjetit “Fox News” dhe agjencisë së lajmeve “Associated Press” që ia kanë dhënë këtë shtet Bidenit.

Deri më tani Bideni kryeson në Arizona, në Xhorxhia, në Nevada dhe në Pensilvani. Faqja në internet “Decision Desk HQ”, e cila merret me analiza dhe parashikime rreth zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara, ka thënë se kandidati demokrat Joe Biden tashmë i ka fituar zgjedhjet presidenciale dhe është zgjedhur president i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sipas kësaj faqeje, Bideni ka shënuar fitore në shtetin kyç, Pensilvani, e bashkë me të edhe 20 votat e Kolegjit Zgjedhor që ka ky shtet.



## Vazhdojnë luftimet në vijën e frontit Azerbajxhan - Armeni



NAGORNO KARABAK, 6 NËNTOR - Luftimet për rajonin e shkëputur të Nagorno Karabakun kanë vazhduar. Autoritetet e rajonit separatist kanë raportuar për vdekjen e të paktën tre civilëve pas bombardimeve nga forcat azerbajxhanase.

Nagorno Karabaku njihet si pjesë e Azerbajxhanit, por armenët etnikë që përbëjnë shumicën e popullsisë refuzojnë sundimin e Azerbajxhanit. Ata kanë qeverisur rajonin, me mbështetjen e Armenisë, që kur trupat e Azerbajxhanit u

dëbuan nga rajoni në një luftë që përfundoi me një armëpushim më 1994. Ndërkohë, Azerbajxhani ka raportuar gjithashtu për granatime të zonave të tij të populluara nga forcat etnike armene. Të dyja palët mohojnë se ata kanë në shënjestër popullatat civile në konfliktin e vazhdueshëm. Të paktën rreth 1 000 njerëz janë raportuar të vrarë që kur shpërthyen luftimet më 27 shtator, duke rritur frikën e një konflikti më të gjerë në Kaukazin e Jugut që mund ta përfshijë Turqinë - anëtare e NATO-s - e cila është një aleate e

Azerbajxhanit dhe Rusinë, e cila ka një pakt ushtarak me Armeninë. Tre armëpushime të ndërmjetësuar nga Rusia, Franca dhe Shtetet e Bashkuara nuk treguan rezultate për ndaljen e luftimeve. Forcat armene dhe ushtria azerbajxhanase pretendojnë se i kanë shkaktuar humbje shkatërruese njëra-tjetrës. Por, raportet nga palët kundërshtarë shpesh janë kontradiktore dhe vështirë të verifikohen. Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë më 22 tetor se Moska beson se gati 5 000 njerëz ishin vrarë në luftime.

## Nigeri, protesta për realizimin e reformës policore

ABUJA, 6 NËNTOR - Policia nigeriane në kryeqytetin Abuja ka përdorur gaz lotsjellës dhe të shtëna me armë për t’i shpërndarë protestuesit, të cilët ishin organizuar për të kërkuar reformë policore, kanë njoftuar të premtën mediat lokale.

Protestuesit, të udhëhequr nga ish-kandidati për president, Omoyele Sowore, është thënë se kanë pikturuar muralin “EndSARS” në rrugën që çon në kompleksin e Asamblesë Kombëtare të vendit, në lidhje

me refuzimin e tyre ndaj asaj që ata e quajnë brutalitetin e policisë, para se forcat e policisë të ndërhyjnë ndaj protestës së tyre, sipas uebfaqes “This Day News”.

Protestat masive në të gjithë vendin kanë filluar në fillim të muajit të kaluar në kryeqytetin komercial Lagos, si protestë kundër vrasjeve dhe keqtrajtimit të raportuara të kryera nga Skuadra Speciale e Policisë Kundër Grabitjes (SARS). Muajin e kaluar presidenti nigerian



Mohammadu Buhari u ka bërë thirrje protestuesve të rinj në të gjithë vendin që t’u japin fund protestave të tyre. Ai ka thënë se huliganët kanë rrëmbyer protestat e mirëfillta dhe të qëllimshme të disa prej të rinjve të kombit në pjesë të vendit dhe kanë shkatërruar pronën publike dhe private. Pavarësisht prej shkrirjes së njësishë SARS si përgjigje të demonstratave, protestat kanë vazhduar kundër asaj që demonstruesit e përshkruajnë si brutalitetin policor.

PKD-ja ka mbajtur konferencë për media pas zhvillimeve të fundit

# Hoxhaj: Lufta e UÇK-së ishte e pastër, Veseli dhe Thaçi u sollën si burrështetas

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë sjellë si burrështetas pas ngritjes së aktakuzës nga Gjykata Speciale. Në një konferencë për media, ai ka deklaruar se ata ishin në lartësinë e burrështetasve të rrallë, që përpara interesit të Kosovës e vendosën çdo interes tjetër. Hoxhaj ka bërë thirrje për maturi dhe bashkim



**EPOKA  
ERE** Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 6 NËNTOR-** Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se lufta e UÇK-së ishte e pastër. Në një konferencë për media, ai ka thënë se konfirmimi i aktakuzës ndaj kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, si dhe ndaj presidentit Hashim Thaçi, si dy figura emblematike të luftës çlirimtare të UÇK-së dhe të lirisë e pavarësisë së Kosovës, flet për një situatë të rëndë jo vetëm për Kosovën dhe aspiratat e saj shtetndërtuese, por në veçanti edhe për PDK-në. “Unë jam i bindur që ata do të dalin fitimtarë e faqebardhë në këtë sfidë të panevojshme e të

mundimshme sepse nuk kam asnjë dyshim që lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë dhe e pastër për liri kundër një pushtuesi që po kryente masakra dhe krime kundër njerëzimit”, ka thënë Hoxhaj.

Më tej, ai ka shtuar se e gjithë bota demokratike besoi në drejtësinë dhe legjitimitetin e luftës sonë, prandaj edhe u solidarizua dhe ndihmoi në çlirimin e Kosovës nga regjimi gjenocidal i Millosheviçit. “Në rrugën e saj të gjatë, me shumë sakrificë dhe duke paguar çmimin e madh të luftës, masakrave e vrasjen e mbi 10 mijë civilëve në vitet '98-'99, Kosova po e paguan edhe një çmim tjetër në rrugën e rëndë të përmbylljes së shtetndërtimit të saj”, ka thënë ai. Sipas Hoxhaj, ata

ishin në lartësinë e burrështetasve të rrallë, që përpara interesit të Kosovës e vendosën çdo interes tjetër. “Ne, miqtë dhe bashkëpunëtorët e z. Kadri Veseli e Hashim Thaçi, që rrugëtuan së bashku në shumë procese jetike për lirinë e pavarësinë e Kosovës, jemi krenarë për ta, të arriturat e tyre dhe sjelljen shembullore prej liderësh historikë. Ata ishin në lartësinë e burrështetasve të rrallë, që përpara interesit të Kosovës dhe popullit të saj, nuk e vendosën asnjë interes

tjetër personal, partiak apo politik”, ka thënë Hoxhaj më tej, i cili, duke bërë thirrje për maturi dhe bashkim, ka thënë se të gjithë duhet të veprojnë në interes të mbrojtjes së të arriturave të Kosovës së pavarur, luftës çlirimtare, UÇK-së dhe shtetit të Kosovës duke mos lejuar vakum e krizë politike apo institucionale. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të PDK-së ka bërë publike edhe vendimet që janë marrë në mbledhjen e fundit të kryesisë së partisë. “Kryesia e partisë ma ka besuar mua

detyrën e ushtruesit të detyrës së kryetarit të partisë. Kjo është një përgjegjësi e madhe për mua e për këdo që do të gjendej në pozicionin tim. Një sfidë e cila mund të përballohet vetëm nëse forcojmë solidaritetin dhe unitetin brenda partisë”, ka thënë Hoxhaj. Në fund, ai ka shtuar se Partia Demokratike e Kosovës ka qenë, është dhe do të jetë trashëgimtare e vlerave më të mira të luftës së popullit shqiptar për liri dhe me krenari do ta mbrojë lavdinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## Veteranët e UÇK-së vendosin për shtyrjen e protestës, kërkojnë pezullimin e dialogut me Serbinë

**PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER)** - Këshilli Drejtues i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka vendosur të premtën për shtyrjen e protestës së paralajmëruar pas arrestimit të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit nga Gjykata Speciale. Ky këshill ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta pezullojë dialogun me Serbinë. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se për shkak të situatës me pandeminë, protesta është vendosur të shtyhet. “Dje kemi pasur mbledhje të kryesisë, ku është propozuar të mbahet një protestë, dhe në mbledhjen e Këshillit Drejtues është



diskuar edhe ky propozim. Këshilli Drejtues ka dalë me disa konkluzione, ku protesta

do të analizohet dhe na ka autorizuar që të diskutojmë me institucionet e

shëndetësisë për të gjetur një kohë të përshtatshme për mbajtjen e protestës. Po

ashtu, kërkuam pezullimin e bisedimeve me Serbinë”, ka thënë Klinaku.



VLERËSOHET LART BASHKËPUNIMI I THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT ME GJYKATËN SPECIALE

## GJAHU I SPECIALES, BASTISEN SHTËPITË E THAÇIT, VESELIT DHE SELIMIT

Një ditë pas ngritjes së aktakuzës dhe dërgimit në Hagë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, hetuesit e Prokurorisë së Specializuar kanë bastisur shtëpitë e tyre. Hetuesit e Speciales kanë qëndruar për disa orë në shtëpitë e ish-drejtnesve më të lartë të UÇK-së. Krahas kësaj, ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së në Kosovë kanë vlerësuar lart bashkëpunimin e liderëve të Kosovës me Gjykatën Speciale. Ata kanë thënë se i vlerësojnë lart fjalimet e Thaçit dhe Veselit të cilët kanë bërë thirrje për respektimin e procesit gjyqësor

vazhdojmë ta bëjmë këtë derisa të përmbushet misioni i dhomave, ndaj të cilave edhe Kosova është e përkushtuar. Kjo është esenciale për konsolidimin e perspektivës evropiane të Kosovës”, është thënë në komunikatë.

### Dhomat e Specializuara publikojnë aktakuzën kundër Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit

Dhomat e Specializuara në Hagë kanë bërë publike aktakuzën për krime lufte kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Aktakuza prej 68 faqesh, që është e redaktuar, është konfirmuar më 26 tetor 2020, kanë njoftuar Dhomat e Specializuara. Sipas aktakuzës, veprat që rëndojnë ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit kanë të bëjnë me krime lufte, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim

mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme dhe krime kundër njerëzimit të burgosjes, akteve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme, zhdukjes me forcë të personave dhe përndjekjes, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit 1998 dhe shtatorit të vitit 1999. Sipas aktakuzës, krimet dyshohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës, por edhe në Kukës dhe Cahan në Shqipërinë Veriore “dhe u kryen nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (‘UÇK’) kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime”. “Ndër viktimat përfshihen persona që dyshoheshin si kundërshtarë të UÇK-së dhe më vonë të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, konkretisht: (i) serbë, romë dhe ashkalinj; (ii) katolikë; (iii) civilë për të cilët pretendohet se bashkëpunonin me autoritetet serbe ose që pretendohet se kontaktonin me serbë; (iv) shqiptarë që ishin anëtarë ose përkrahës të Lidhjes Demokratike të Kosovës ose të partive të tjera që konsideroheshin se ishin kundër UÇK-së; (v) shqiptarë që nuk iu bashkuan ose nuk përkrahnin UÇK-në; dhe (vi) individë të punësuar ose të punësuar të mëparshëm që konsideroheshin kundër UÇK-së”, është thënë në njoftimin e Dhomave të

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 6 NËNTOR-** Hetues të Prokurorisë së Specializuar në Hagë dhe policë të EULEX-it kanë bastisur të premtën shtëpitë e ish-presidentit Hashim Thaçi, shefit të PDK-së, Kadri Veseli, dhe ish-shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Këto bastisje kanë ndodhur një ditë pasi ata janë transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, pas konfirmimit të aktakuzave për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Ndërkohë udhëheqësit e misionëve diplomatike të vendeve anëtare të BE-së në Kosovë kanë vlerësuar bashkëpunimin e liderëve të Kosovës me Gjykatën Speciale dhe thirrjet e tyre për respektim të procesit gjyqësor. “Ne e vlerësojmë bashkëpunimin e treguar në ditët e fundit nga presidenti Hashim Thaçi dhe ish-udhëheqësi i PDK-së, Kadri Veseli,

si dhe nga z. Rexhep Selimi dhe ish-kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, me Dhomat e Specializuara. Për më tepër, ne i vlerësojmë fjalimet drejtuar publikut të mbajtura dje nga z. Thaçi dhe z. Veseli, të cilët bënë thirrje për respektimin e procesit gjyqësor”, është thënë në komunikatën për media.

Sipas këtyre misionëve, kjo pasqyron përgjegjësinë dhe vendosmërinë e Kosovës për respektim të sundimit të ligjit dhe për kërkim llogarie nga individët që mund të kenë kryer veprime të

paligjshme. “Nuk duhet harruar se, sipas ligjit, individët nën aktakuzë janë të pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tyre dhe se duhet të respektohen të drejtat e tyre ligjore. Kosova duhet të mbetet e përkushtuar ndaj këtij procesi. Prioriteti më vendimtar për BE-në dhe shtetet e saj anëtare është respektimi i sundimit të ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, ne e kemi mbështetur fuqimisht krijimin e Dhomave të Specializuara si pjesë integrale e sistemit të Kosovës për sundimin e ligjit dhe do të

### Më 9 nëntor Thaçi dhe Krasniqi dalin para Gjykatës Speciale

Gjykata Speciale ka dhënë detaje për paraqitjen e parë të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, para Tribunalit Special. Në njoftimin e

Speciales është thënë se Thaçi do të dalë para Dhomave të Specializuara më 9 nëntor, në orën 15:00. Po këtë ditë, para Speciales pritet

të dalë edhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi. Sipas njoftimit, seanca për Krasniqin do të mbahet prej orës 11:00.

Specializuara. Dhomat e Specializuara pretendojnë se për këto krime, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi mbajnë përgjegjësi penale si individë në bazë të formave të ndryshme të përgjegjësisë penale për krimet e paraqitura në aktakuzë, “që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe në kuadrin e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave të dyshuar si kundërshtarë të UÇK-së”. Në aktakuzë pretendohet se nga marsi i vitit 1998 deri në shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të “ndërmarrjes së përbashkët kriminale kanë ndarë qëllimin e njëjtë për ta marrë dhe ushtruar kontrollin në gjithë Kosovën me të gjitha mjetet, përfshirë edhe frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e atyre që i konsideronin kundërshtarë”. Kundërshtarët, sipas aktakuzës, ishin njerëz që u perceptuan se kanë “bashkëpunuar me forcat e ish-Republikës Jugosllave, me zyrtarët apo institucionet shtetërore ose nuk mbështesnin qëllimet e UÇK-së, përfshirë personat e lidhur me LDK-në dhe

persona të etnisë serbe, rome dhe etnive të tjera”.

### Pallaska flet si avokat i Thaçit: Prokuroria ende po kërkon prova për ta mbështetur aktakuzën kundër tij

Dastid Pallaska, në cilësinë e njërit prej avokatëve mbrojtës të Hashim Thaçit në procesin gjyqësor në Hagë, ka dhënë më shumë detaje për bastisjen shtatorëshe në rezidencën e ish-presidentit. “Dëshiroj që t’ju njoftoj se e kam pranuar ftesën e presidentit Hashim Thaçit që t’i bashkohem ekipit të tij të mbrojtjes i cili përbëhet nga një numër i avokatëve ndërkombëtarë dhe i cili do ta përfaqësojë atë në procedurën penale që ka filluar kundër tij pranë Dhomave të Specializuara. Sot në këtë cilësi isha i pranishëm gjatë zbatimit të urdhrat të bastisjes në rezidencën e Hashim Thaçit këtu në Prishtinë, përkatësisht në Graçanicë. Atë që mund t’ju them për momentin është që bastisja ka përfunduar, derisa sa iu përket qëllimeve të bastisjes, mund të them që ato ishin jashtëzakonisht të përgjithshme”, ka thënë ai. Pallaska ka thënë se është e paqartë pse bastisja është kryer pas

## KMDLNj: EULEX-i po e përdor Policinë e Kosovës si “punëtorë krahu”

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ndaj bastisjeve që po bëhen nga EULEX-i në shtëpinë e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, dhe shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Në reagimin e KMDLNj-së është thënë se policia e EULEX-it po shpërfill skajshmërisht institucionet e Kosovës, ndërsa Policinë e Kosovës po e përdor si “punëtorë krahu”. “Vlen të theksohet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selim dje, sikur

edhe Jakup Krasniqi para dy dite, nuk kundërshtuan me asgjë ndërhyrjen e Gjykatës Speciale, madje bënë thirrje publike që të mos protestohet apo kundërshtohet në çfarëdo forme puna e Gjykatës Speciale. Policia e EULEX-it po shpërfill skajshmërisht institucionet e Kosovës, ndërsa Policinë e Kosovës po e përdor si ‘punëtorë krahu’, ndonëse më parë kryetarja e kësaj Gjykate pati deklaruar se pikërisht Policia e Kosovës do të ketë mandat për bastisje dhe arrestime eventuale”, ka vlerësuar KMDLNj-ja.



## Veliu: Kemi plan për parandalimin e ndonjë incidenti të mundshëm pas zhvillimeve me Specialen

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, gjatë mbledhjes së qeverisë ka komentuar zhvillimet e fundit dramatike rreth Gjykatës Speciale. Ai ka thënë se gatishmëria e të akuzuarve për bashkëpunim me Hagën ka vërtetuar pjekurinë politike dhe idealin që ka pasur lufta jonë. “Gatishmëria për bashkëpunim me Prokurorinë Speciale e të akuzuarve vërteton pjekurinë politike dhe idealin që ka pasur lufta jonë”, ka thënë ai. Veliu ka

bërë me dije se kanë edhe një plan për të parandaluar ndonjë incident të mundshëm pas këtyre zhvillimeve. “Policia ka inkorporuar në planin e saj, përfshirë masat që kanë mbrojtjen e zonave në popullsi të përzier në rast të ndonjë incidenti të mundshëm, por edhe plani që përmban të gjitha skenarët e mundshëm. Policia ka vendosur me të gjitha mjetet të përgjigjur në një situatë të mundshme. Është rritur niveli i gatishmërisë”, ka thënë Veliu.

konfirmimit të aktakuzës, derisa ka shtuar se Prokuroria është duke kërkuar ende prova për ta mbështetur aktakuzën tanimë të konfirmuar. “Rrjedhimisht nuk dukej që kishte ndonjë shënjestrim të duhur të bastisjes që është parakusht procedural që të urdhërohet bastisja. Po ashtu, dhe pa e nënvlerësuar këtë fakt, mbetet ende e paqartë, si në aspektin

procedural ashtu edhe atë logjik, që bastisjet të kryhen pas ngritjes së aktakuzës, përkatësisht konfirmimit të saj. Ajo që kjo bastisje sugjeron është që aktakuza kundër Hashim Thaçit, ashtu siç është konfirmuar, mbetet një shënjestër në lëvizje. Prokuroria duket se ende kërkon prova për të mbështetur një aktakuzë që tani e ka ngritur”, ka thënë Pallaska.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për dialog, konsideroj se fillimisht Qeveria e Kosovës duhet të pezullojë menjëherë dialogun deri në një moment tjetër”, ka thënë ai. Ai ka thënë se aktakuza e Gjykatës Speciale duhet qartë të sqarohet që nuk vepron me prova të konstruktura nga eksponentët e forcave serbe të sigurisë. “Këto aktakuza më shumë se kanë qenë efekt juridik, po prodhojnë efekte politike me qëllim të dobësimit të pozicionit tonë ndërkombëtar, përballë së cilave nuk duhet të qëndrojmë duarkryq”, ka thënë Selimi.

### Ministri i Drejtësisë kërkon pezullimin e dialogut me Serbinë

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), parti që është pjesë e koalicionit qeverisës, ka kërkuar në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, që të pezullohet menjëherë dialogu me Serbinë, i cili zhvillohet me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian në Bruksel. Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi (AAK), në mbledhjen e kabinetit qeveritar ka thënë se ky proces duhet të pezullohet deri në një moment tjetër. “Si ministër i Drejtësisë, por edhe si qytetar i këtij vendi, i deleguar edhe nga

Por, ndaj deklaratave të ministrit të Drejtësisë ka ndërhyrë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka thënë se duhet ta respektojmë parimin e ndarjes së pushteteve. “Besoj se ministri i Drejtësisë e ka të qartë më shumë se të gjithë këtë çështje. Ne nuk ndërhyjmë dhe nuk komentojmë vendimet e organeve të drejtësisë. Më lejoni t’ju them qartë: në Qeverinë e Kosovës nuk ka hapësirë për sjellje ndryshe”, ka thënë Hoti.



USHTRUESJA E DETYRËS E PRESIDENTIT, VJOSA OSMANI, BËN HOMAZHE NË "VELANI" DHE PREKAZ

# Osmani thotë se do të angazhohet për bashkimin e skenës politike

Vjosa Osmani e ka nisur punën si ushtruese e detyrës e presidentit me homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Nga "Velania" dhe Prekazi, Osmani ka thënë se do të angazhohet për bashkimin e skenës politike, sidomos në këtë kohë të vështirë që është duke kaluar vendi. Më tutje, Osmani ka thënë se Prekazi është dëshmia e drejtpërdrejtë e mendësisë shfarosëse dhe gjenocidale e Serbisë në Kosovë. "Këtu në Prekaz ne mund ta shohim edhe dëshminë e drejtpërdrejtë për krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin që ka kryer Serbia në Kosovë", ka thënë Osmani



shprehur ajo.

Pas homazheve te varri i Rugovës, Osmani ka shkuar edhe në Prekaz, konkretisht në Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Ajo ka thënë se vizita në Prekaz nuk është thjesht ceremoni, por ka të bëjë me simbolikë. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se Prekazi është vend që frymëzon bashkim nëpër sfidat që po kalon Kosova. "Kjo nuk është thjesht një ceremoni. Në momente të vështira kjo është arsyeja e vizitës sime për t'i vizituar vendet që frymëzojnë bashkim. Unë besoj që si rregull Kushtetuta e përcakton

se secilën detyrë që ka presidenti e ka edhe ushtruesi i detyrës. Veprimet juridike nuk duhej të merrnin komente politike", ka thënë Osmani. Më tutje, Osmani ka thënë se Prekazi është dëshmia e drejtpërdrejtë e mendësisë shfarosëse dhe gjenocidale e Serbisë në Kosovë. "Këtu në Prekaz ne mund ta shohim edhe dëshminë e drejtpërdrejtë për krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin që ka kryer Serbia në Kosovë. Përveç sakrificës së Adem Jasharit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij, 21 anëtarë të familjes që janë

vrarë e masakruar këtu janë fëmijë, të moshave të ndryshme, ndërkaq nëse e shohim numrin e përgjithshëm, diku 2/3 e personave të vrarë e të masakruar janë gra, fëmijë e pleq, që tregon për mendësinë gjenocidale dhe mendësinë shfarosëse e cila ka ekzistuar në Serbi, e për të cilën, për fat të keq, Serbia ende nuk kërkon falje", është shprehur Osmani. Vjosa Osmani është duke ushtruar detyrën e presidentes të vendit pas dorëheqjes së Hashim Thaçit nga kjo pozitë për shkak të aktakuzës nga Gjykata Speciale.

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË/PREKAZ, 6 NËNTOR** - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, në ditën e parë të punës në këtë pozitë, ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te varrezat e familjes Jashari në Prekaz. Meqë tani ushtron detyrën e njëjtë me ish-presidentin e ndjerë Rugova, Osmani ka thënë se nga kjo pozitë ka shkruar për ta nderuar veprën e Rugovës dhe kontributin e tij për bashkimin e shqiptarëve kur kauzë ishte liria e vendit. "Rugova ishte njeriu që nëpërmjet një politike të pashembullt arriti t'i bashkojë shqiptarët për një kauzë të

përbashkët. Ai u siguria që bota ta marrë vesh jo vetëm ku është Kosova, por edhe që ta marrë vesh për çdo krim që Serbia kreu në Kosovë. Prandaj, jemi këtu për ta nderuar atë punë dhe sakrificë të tij", ka thënë Osmani. Ndërsa për rolin e saj të ri për bashkimin e një skene politike të përçarë, Osmani ka thënë se do ta japë maksimumin, por se në të njëjtën kërkon edhe nga secila parti politike. "Kjo është kompetencë dhe përgjegjësi kushtetuese e imja, por është përgjegjësi edhe e partive politike që të unifikohen, sepse besoj se qytetarët nuk do ta falin askënd që në këtë kohë të rëndë për Kosovën, kur ne duhet të flasim njëzëri, të bëhemi peng i politikave dhe dallimeve ditore", është

## Diskutohet për Ligjin e të pagjeturve

**PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER)** - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, së bashku me nënkryetaren e Kuvendit të Kosovës, Abërie Nagavci, si dhe ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, kanë takuar përfaqësueset e organizatës "Thirrjet e nënave" nga Gjakova. Në këtë takim është diskutuar për Ligjin për të pagjeturit, i cili nga të pranishmit në takim është konsideruar i domosdoshëm. Me këtë rast, Osmani ka kërkuar që procesi i hartimit të Ligjit për të pagjeturit të finalizohet në një periudhë të afërt dhe i njëjti të miratohet në Kuvend. Po ashtu, ajo ka kërkuar koordinim ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës që në tekstin final të këtij ligji të


përfshihen edhe rekomandimet e organizatës "Thirrjet e nënave" dhe organizatave të ngjashme që përfaqësojnë familjet e të pagjeturve. Përmes këtij ligji, ndër të tjera, do të mundësohej edhe përkrahja institucionale për familjet e të pagjeturve. Ndërsa ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka shprehur gatishmëri dhe Qeverisë së Kosovës që ky ligj të miratohet sa më parë dhe i njëjti të procedohet për miratim në Kuvend. Në anën tjetër, Osmani dhe nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, kanë thënë se Kuvendi do ta shtyjë përpara përsipër këtë çështje duke shpresuar që ky ligj ta marrë përkrahjen e nevojshme të të gjitha grupeve politike.



REKORD I ZI: 12 TË VDEKUR, 60 TË SHËRUAR DHE 728 RASTE TË REJA ME COVID NË 24 ORËT E FUNDIT

# Koronavirusi, i ashpër në Kosovë

Rastet e reja me Covid-19 janë duke shënuar rritje të madhe në Kosovë. Vetëm gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë janë paraqitur 728 raste të reja me Covid. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore 12 persona e kanë humbur betejën me Covid, duke e ngrehur në 732 numrin e përgjithshëm të të vdekurve. IKShPK-ja ka njoftuar se në Kosovë janë 6 221 raste aktive me Covid. Krahas publikimit të këtyre statistikave, IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë masat anti-Covid

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 6 NËNTOR** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur 12 persona si pasojë e infektimit me Covid dhe janë paraqitur 728 raste të reja. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 60 persona nga Covidi. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 827 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 728 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 12 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren 3 raste (80, 74 dhe 57 vjeç), Gjilan 2 raste (81 dhe 73 vjeç), Prishtinë 2 raste (86 dhe 81 vjeç), Fushë Kosovë 1 rast (59 vjeç), Gjakovë 1 rast (85 vjeç), Mitrovicë 1 rast (78 vjeç), Obiliq 1 rast (79 vjeç) dhe Vushtrri 1 rast (67 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 22 934 raste nga 103 839

persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 732 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 60 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 981 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 221", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se prej 728 rasteve të reja me Covid-19 në Prishtinë janë paraqitur 316 raste të tilla. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 316 raste, komuna Gjilan 52 raste, komuna Prizren 47 raste, komuna Gjakovë 45 raste, komuna Pejë 41 raste, komuna Ferizaj 25 raste, komuna Fushë Kosovë 25 raste, komuna Mitrovicë 21 raste, komuna Suharekë 18 raste, komuna Vushtrri 18 raste, komuna Shtime 16 raste, komuna Lipjan 15 raste, komuna Podujevë 14 raste, komuna Drenas 11 raste, komuna Kaçanik 11 raste, komuna Deçan 9 raste, komuna Obiliq 9 raste, komuna Klinë 6 raste, komuna Viti 6 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Hani i Elezit 3 raste, komuna Novobërdë 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste,

komuna Dragash 2 raste dhe komuna Istog 1 rast. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë!", ka njoftuar IKShPK-ja.

**IKShPK-ja, qytetarëve: Mos lejoni mbylljen e të gjithëve për pakujdesinë e disave!**

Pas rritjes të rasteve të reja me Covid, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore. "Mos lejoni mbylljen e të gjithëve për pakujdesinë e disave! Kudo që vëreni persona që nuk iu përmbahen rekomandimeve, këshillojini! Këshillimi është obligim qytetar. Ju lutemi për kujdes të shtuar! Virusit është kudo! Virusit vret! Ju lutemi përmbajuni rekomandimeve! Mos e nënvlerësoni virusin!", është thënë në reagimin e IKShPK-së.

Ky institut ka theksuar se pakujdesia na dërgon shumë shpejt në mbingarkesën e institucioneve shëndetësore dhe


shtimin e rasteve fatale. "Asnjë vend në botë nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe infrastrukturë spitalore të përballojë shtimin e rasteve për shkak të papërgjegjësive në moszbatimin e rekomandimeve tashmë të vetme në mbarë botën: maska, distanca, higjiena! Sot janë konfirmuar 728 raste të reja me Covid-19 për shkak të pakujdesisë tonë. Ky është numër rekord deri tani. Numri i rasteve javën e fundit ka pësuar rritje si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. Ju lutemi mbani maskën, mbani distancë dhe higjienën personale. Këto ditë vërehet fluks i shtuar i lëvizjes së qytetarëve kudo nëpër Kosovë. Kjo është sjellje e rrezikshme dhe lehtësimi i lëvizjes nuk nënkupton mosrespektimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë", është thënë në këtë reagim, duke shtuar se pakujdesia e disa qytetarëve gjatë këtyre lëvizjeve dhe aktiviteteve, shton rrezikun e përhapjes së infeksionit, përderisa virusi SARS-COV-2 është i pranishëm në vendin tonë. "Dhe kështu mund të mbingarkohet sistemi

shëndetësor me pasojë të paparashikuara deri në shpërthim e që mund të paraqesë rrezik për jetën e qytetarëve. U bëjmë thirrje qytetarëve, institucionet publike dhe private, bizneseve, gastronomëve, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. Burimet e infeksionit janë të shpërndara në institucione publike, private, agjenci, shkolla e amvisëri të cilët kanë mundur të infektohen kudo prej vendit të punës në institucione publike e private, gastronomi, supermarketet, ku pjesa dërrmuese shihen pa maska në vende të punës. Si pasojë e mosbartjes së maskave nga ju, qytetarë të nderuar, po rrezikohet shëndeti juaj dhe i qytetarëve të tjerë dhe po rëndohet situata e përgjithshme epidemiologjike që po mbahet nën kontroll me mund të madh të ekipeve të profesionistëve të Institutit Kombëtar", është thënë në reagimin e IKShPK-së.

## Kosova mbyllet në fundjavë për mbrojtje nga pandemia

**PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER)** - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të premtën, në orën 20:00 e deri të hënën në orën 05:00, t'u ndalohej veprimtaria të gjitha subjekteve afariste dhe bizneseve, me qëllim frenimin e përhapjes së koronavirusit. Ministria e Shëndetësisë, duke u bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Komitetit për Koordinimin dhe Vlerësimin e situatës emergjente nga pandemia e Covid 19, ka propozuar vendimin për ndërmarrjen e masave të mbrojtjes nga pandemia Covid-19 si në vijim: Ndalohet veprimtaria e të gjitha subjekteve afariste dhe bizneseve, qendrave tregtare e rekreative, supermarketeve, subjekteve që ofrojnë shërbimet e gastronomisë (restorantet, kafiteritë dhe të

ngjashme) në tërë territorin e Republikës së Kosovës, prej orës 20:00, më 06/11/2020 (e premte) deri më 09/11/2020 (e hënë) në orën 05:00, përveç: furrave të bukës, barnatoreve, marketeve të vogla, pompave të derivateve. Sipas këtij vendimi, institucionet shëndetësore publike dhe private lejohen për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale. Sipas këtij vendimi, obligohet Policia e Kosovës të bëjë kontroll rigoroz për zbatim të masave, vendimeve dhe Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës. "Për të gjithë shkelësit e këtyre masave, organet kompetente obligohen t'i shqiptojnë masat ndëshkimore konform Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës", ka njoftuar qeveria.



# Çmimet e prodhimeve blegtorale shënuan rritje për 3.09 për qind

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se në tremujorin e tretë të vitit 2020 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 3.09 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, sipas ASK-së, ka shënuar rënie për -1.36 për qind. “Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 2.98 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019”, është thënë në njoftimin e ASK-së

## /Epoka e re/

**PRISHTINË, 6 NËNTOR-** Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar “Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi” për tremujorin e tretë (TM3 2020). ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazë të indeksit nga 2010=100 në 2015=100 sipas metodologjisë së Eurostatit. Sipas ASK-së, ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të

grumbullohen. “Prodhimet, të cilat krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore, janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula”, ka njoftuar ASK-ja, duke shtuar se këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të



kafshëve. “Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë”, ka njoftuar ASK-

ja. Sipas ASK-së, në tremujorin e tretë të vitit 2020 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 3.09 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve

bimore ka rënie për -1.36 për qind. Ndërsa indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 2.98 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019”, ka njoftuar ASK-ja.

## Shkarkohet kryeshefi i KOSTT-it

Prishtinë, 6 nëntor (ER) - Kryeshefi Ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT), Ilir Shala, është shkarkuar të premten nga kjo pozitë nga bordi i këtij institucioni. Ai këtë shkarkim e ka cilësuar të pabazë dhe ka paralajmëruar ndjekjen e rrugëve ligjore kundër këtij vendimi. “Bordi i drejtorëve i KOSTT-it, i kryesuar nga Jeton Mehmeti dhe Nebih Zariqi, Ajrina Gashi-Hamdiu, Xhyldane Kiqmari dhe Arben Dodaj, vendosi për shkarkimin tim nga pozita e kryeshefit ekzekutiv dhe kthimin në pozitën e kryeshefit ekzekutiv të Mustafë Hasanit, duke u arsyetuar në zbatimin e urdhrit përmbartimor të Gjykatës Përmbartimore, pas vendimeve të marra me standarde të dyfishta të Inspektoratit të Punës dhe duke mos zbatuar udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 189/2020, datë 25.09.2020, për moszbatim të



vendimeve të Inspektoratit të Punës nga gjykata përmbartimore”, ka shkruar Shala

në llogarinë e vet në “Facebook”. Më tutje, ai ka thënë se do t'i ndër marrë të gjitha veprimet

ligjore ndaj këtij vendimi. “Si do që të jetë, unë me përgjegjësi morale dhe ligjore do t'i marr të

gjitha masat për ndjekjen e të drejtës sime ligjore qoftë përmes procedurës penale apo civile. Dua të falënderoj dhe njëkohësisht i kërkoj falje shumë familjes sime që s'kam mundur të jem 100 për qind i përkushtuar ndaj saj, por më shumë i përkushtuar për interesat dhe arritjet historike që bëmë bashkë me grupin punues dhe gjithë punonjësit e KOSTT-it: Formimi i Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri, Marrëveshjen e re KOSTT - ENTSO-E, ku definohet pavarësia energjetike e Kosovës, Themelimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike. Jam krenar dhe shumë i lumtur për të arriturat e fundit të KOSTT-it, nën udhëheqjen time, që bëmë bashkë me punonjësit e KOSTT-it dhe me përkrahjen miqve tanë ndërkombëtare: U. S. Embassy Pristina, Kosovo, USAID Kosovo, German Embassy Pristina, Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW). E drejta do të triumfojë”, ka shkruar Shala.

## Më 13 nëntor mbahet ankandi i trembëdhjetë i letrave me vlerë për vitin 2020

**PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER)** - Ministria e Financave ka njoftuar se më 13 nëntor 2020 do të mbahet ankandi i trembëdhjetë për vitin 2020.

Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 22.50 milionë eurosh. Investimi në obligacione

është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për borxhin publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë

kohëzgjatjen (2 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. “Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit

të kontaktojnë ndonjërin nga Bankat Komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës”, ka njoftuar Ministria e Financave.



# Punëtorët e Telekomit i japin ultimatum qeverisë deri të hënën

Punëtorët e Telekomit të Kosovës kanë protestuar në shenjë revolte ndaj bllokimit të xhirollogarive të këtij institucioni. Në emrin e tyre, kryetari i Sindikatës i Punëtorëve të Telekomit, Lami Balaj, u ka dhënë ultimatum institucioneve të vendit që të zhblokohen xhirollogaritë deri të hënën, më 9 nëntor, në të kundërtën ka paralajmëruar grevë dhe protesta 24-orëshe



zhblokohen xhirollogaritë, do të ketë protesta më të mëdha. "Nëse deri të hënën në orën 16:00 nuk do të ketë lëvizje nga Qeveria e Kosovës atëherë të martën të gjithë do të jemi para qeverisë së Kosovës, por nëse qeveria nuk e merr për

bazë kërkesën tonë, mos harroni se kjo protestë do të shpërndahej edhe aty ku do t'u dhëmbë më së shumti edhe klaneve të interesit edhe mafiozëve, por edhe një pjese të njerëzve që kanë qenë e janë në pushtet, e që po mbrojnë

klanin mafioz", ka thënë ai. Balaj ka thënë se mafiozët po synojnë ta dërgojnë Telekomin drejt falimentimit. Ditë më parë Telekomit i janë bllokuar xhirollogaritë për shkak të borxhit ndaj kompanisë "Dardafon.net".

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 6 NËNTOR-** Punëtorët e Postës dhe të Telekomit të Kosovës kanë protestuar të premten para objektit të këtij institucioni, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës zhblokimin e xhirollogarive të kësaj ndërmarrje. Ata i kanë dhënë ultimatum ekzekutivit deri më 9 nëntor që t'i marrë parasysh kërkesat e tyre, në të kundërtën kanë paralajmëruar grevë dhe protesta 24-orëshe para objektit të qeverisë.

Lami Balaj, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, ka thënë se kërkesë e vetme e tyre është zhblokimi i xhirollogarive dhe që të njëjtat mos të bllokohen më. Ai ka paralajmëruar kaos social nëse nuk ndërmerret

diçka në këtë drejtim. "Kryeprokurorit Lumezi, kryeministrit dhe të gjithë aktorëve të tjerë po ua bëj me dije, se kaosi social e kanë në derë. Kur them kaosi social, them se mirëqenia sociale e punëtorëve është më e rëndësishmja. Sot rreth 3 300 punëtorë të Postës dhe Telekomit të Kosovës janë pa paga. Jemi në një gjendje kaotike. Grupet kriminale të interesit, bashkë me njerëzit brenda ndërmarrjeve publike ose brenda Telekomit, ose me njerëzit jashtë Telekomit, të përkrahur edhe nga qarqet politike, e kanë sjellë Telekomin në këtë gjendje", ka thënë Balaj.

Më tutje, Balaj ka thënë se i japin ultimatum ministrit të Ekonomisë, Blerim Kuçi, deri ditën e hënën dhe nëse deri atëherë Telekomit nuk i

## Dështon seancën për Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike

Në saje të mos respektimit, të orarit në të cilin ishte paraparë të mbahet seanca e jashtëzakonshme ku pritej votimi i Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike, është shtyer votimi për ujavën e arshme. Këtë e ka konfirmuar nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala. "Nuk ka kuorum për mbajtjen e kësaj seance. Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi duke marrë parasysh zhvillimet politike në vend, ka kërkuar që kjo seancë të shtyhet për datën 11 nëntor 2020", u shpreh Shala



dështimeve, Kuvendi i Kosovës me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim kishte

votuar në lexim të parë këtë projektligj. Me anë të këtij projektligji parashihet zbatimi i

pakos së rimëkëmbjes ekonomike në vlerë prej 365 milionë eurosh. (A. MAVRAJ)

**EPOKA ERE** A.MAVRAJ

**PRISHTINË, 6 NËNTOR -** Prishtinë, 6 nëntor - Ka dështuar të mbahet seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës ku ishte paraparë të hidhet për votim në lexim të dytë Projektligji për rimëkëmbje ekonomike. Kjo seancë nuk është mbajtur si rezultat i mungesës së një numri të madh të deputetëve. Këtë e ka konfirmuar nënkryetari i Kuvendit nga radhët e LDK-së,

Kujtim Shala. "Nuk ka kuorum për mbajtjen e kësaj seance. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, duke marrë parasysh zhvillimet politike në vend, ka kërkuar që kjo seancë të shtyhet për datën 11 nëntor 2020", ka thënë Shala. Projektligj për rimëkëmbje ekonomike parashihet plotësimin e një sërë ligjesh, i cili përfshinë edhe tërheqjen e mjeteve nga Trusti në shumën prej 10 përqindësh. Ndryshe, më 12 tetor, pas gjashtë

# Pas arrestimeve në Kosovë: Mbrojtja në Hagë dhe dy alternativat e brendshme



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Arrestimet në ditët e fundit në Kosovë nuk kanë qenë të panjohura dhe për pasojë të papritura. Dorëheqja e ish-presidentit Thaçi, drejtuesit të PDK-së, Kadri Veselit, ish-kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqit dhe kryetarit të grupit parlamentar të LV-së, Rexhep Selimit, në një farë mënyre janë ngjarje të paralajmëruara prej kohësh. Së paku, prej vitit 2000 ish-prokurorja e Hagës, Karla del Ponte, e një vit më pas prokurori i Zvicrës, Dik Marti, bënë publike akuzat kundër eksponentëve të lartë të UÇK-së. Në vitin 2015 Bashkimi Evropian dhe ShBA rritën presionin për krijimin e dhomave speciale, respektivisht të prokurorisë dhe Gjykatës Speciale për Kosovën. Mbas shumë debateve, hezitimeve, qëndrimeve pro dhe kundra, Kuvendi i Kosovës, në 2015 bëri amendamente kushtetuese dhe më pas u miratua ligji dhe statuti i krijimit dhe funksionimit të dy dhomave speciale për Kosovën. Mbas pesë vitesh investigimesh, në qershor 2020, dhoma speciale e prokurorit bëri publike akt-akuzën kundër z. Thaçi. Në nëntor po të këtij viti aktakuza e prokurorit special u konfirmua nga gjykatësi special. Pas këtij konfirmimi, ish-presidenti Thaçi dhe bashkëpunëtorët e tij të afërt të luftës dhe të punës, Veseli, Krasniqi dhe Selimi u arrestuan dhe u nisën për në Hagë.

Kështu, Kosova është futur në një situatë krize që ka dy dimensione: së pari, është krizë që ka të bëjë me drejtësinë, ballafaqimin me akuzat dhe me ligjin, pra një proces prokurorial dhe gjyqësor dhe, së dyti, është krizë politike dhe institucionale, që duhet adresuar me qetësi, maturi dhe përgjegjësi të lartë. Të dy krizat janë të ndërlidhura dhe me ndikime ndërmjet tyre. Ndonëse ballafaqimi me drejtësinë është proces juridik i pavarur, sërish, konsekuencat e tij do jenë edhe politike e shtetërore për Kosovën e fatin e saj. Aktakuzat dhe arrestimet një grupi relativisht të madh eksponentësh në nivele të larta që kanë përfaqësuar për shumë vite shtetin e Kosovës, pa pikë dyshimi krijojnë probleme të mëdha brenda dhe jashtë Kosovës, lënë pas një vakum në lidhshmëri e vendit dhe trondit imazhin dhe reputacionin ndërkombëtar të saj. Kjo situatë lypet të përballohet në dy dimensionet e saj: në aspektin gjyqësor dhe në aspektin politik e shtetëror.

## 1. Të zbardhet e vërteta për individët, të mbrohet UÇK-ja

Askush nuk mund të ç'bëjë tanimë ekzistencën e dhomave speciale dhe veprimtarinë e tyre për Kosovën. Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës i kanë bërë ato legjitime. Dy dhomat janë pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë, por që kanë trupë prokurorale, gjyqësorë të huaj, kanë qendrën në Hagë dhe dëshmitarët e lidhur me proceset e tyre do të gëzojnë mbrojtje të veçantë jashtë Kosove. Tani që procesi ka nisur gjerësisht, nuk është koha as për mburrje historiko-patriotike, për qarje dhe ankime dhe as për zhurmë propagandistike të brendshme, as

për protesta e manifestime të çfarëdo lloji. Kosova është përballë një procesi që e ka pranuar me vullnetin e vet. Tani ky proces kërkon përballje. E përballja ka nevojë për mbrojtje të fuqishme, të dinjitetshme dhe profesionale. Mbrojtja nuk i duhet lënë rastësisë dhe as vetëm individëve të veçantë. Duke qenë një rast që lidh pashqitshëm individë me historinë e Kosovës, UÇK dhe luftën e saj është e domosdoshme që të krijohet një studio e kompletuar mbrojtjeje me avokatë vendas dhe të huaj, ekspertë të së drejtës penale të Kosovës dhe asaj ndërkombëtare. Krijimi, mbështetja dhe financimi i mbrojtjes lypet të mendohet mirë dhe me kujdes. Procesi do jetë relativisht i komplikuar dhe i gjatë. Në aktakuzën e publikuar ditën e e arrestimit të ish-zyrtarëve të lartë të Kosovës ka parashtrime të shumta, të komplikuar, kontroverze, por edhe shumë të rënda. Diku në mes rreshtave akt-akuza e quan grupin e arrestuar si "Joint Criminal Enterprise", pra një "Sipërmarrje Kriminale të Përbashkët" ose një "Grup të Strukturuar Kriminal", një formulimakuze që hedh dyshime të rënda mbi një grup të madh drejtuesish të UÇK dhe më pas të udhëheqjes së Kosovës. Përmenda këtë pjesë nga akt-akuza publike për të bërë me dije se kemi të bëjmë me një proces ku është bërë mpleksje e akuzave individuale me akuzë në grup, çka e rëndon shumë më tepër këtë proces, duke implikuar udhëheqjen e UÇK, politikën, qëndrimet dhe vendimet e saj si organizatë. Prandaj, mbrojtja është përballë një sfide të konsiderueshme për të hedhur dritë mbi të vërtetën dhe për të mbrojtur përballë gjykatës individët dhe UÇK, e historinë e saj të lavdishme njëkohësisht.

## 2. Jo instrumentalizim politik, por zgjidhje të krizës

Bazuar në Nenin 90 të Kushtetutës së Kosovës, paragrafin 1 thuhet "Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij/saj, ajo/ai mund t'ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij/saj, Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës". Në paragrafin 2 thuhet... "Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është përkohësisht i paafte për të ushtruar përgjegjësitë e veta... Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës"... Dhe në paragrafin 3 thuhet se "Posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj". Sikundër shihet Kushtetuta e Kosovës nuk ka parashikuar posaçërisht dorëheqjen e presidentit të Kosovës specifikisht. Por, kjo mangësi, nuk e pengoi Kosovën në rastin e dorëheqjes së z. Thaçi dhe arrestimit dhe dërgimit të tij në Hagë, për të ngarkuar në ushtrimin e detyrës së presidentit të Kosovës për 6 muaj, kryetaren e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani. Brenda 6 muajve Kosova është përballë dy alternativave: ose të arrijë një kompromis politik dhe institucional të gjerë dhe gjithëpërfshirës, ose të shkojë drejt zgjedhjeve të reja. Të dy këto alternativa kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Alternativa e parë, pra kompromisi i gjerë politik dhe institucional ka avantazh sepse do të mund të siguron të një stabilitet dhe qëndrueshmëri politike, institucionale dhe

shoqërore në Kosovë, duke shmangur vakuimet, tensionet, polarizimet dhe instrumentalizimet politike për proceset e Hagës. Disavantazhi është se ky kompromis do të dobësonte pluralizmin politik, debatin dhe në një farë mënyre edhe legjitimitetin e institucioneve qeverisë në vend. Alternativa e dytë, pra që lidhet me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme brenda 6 muajve të ardhshëm do kishte avantazh se do të sillte një ri-legjitimim të institucioneve qeverisë të Kosovës në të gjitha institucionet e saj, në Kuvend, Presidencë dhe Qeveri. Zgjedhjet legjitimojnë institucionet dhe drejtuesit e Kosovës me votën e lirë dhe të ndershme të qytetarëve të Kosovës. Natyrisht, legjitimiteti do ishte edhe një stabilitet e demokratizim më afatgjatë institucionalisht. Disavantazhi i alternativës së zgjedhjeve të parakohshme është rreziku i lartë i instrumentalizimit politik të procesit të nisur në Hagë, instrumentalizim, i cili në procesin zgjedhor e më pas do rriste tensionet, polarizimin, ndarjen dhe pse jo, edhe konfrontimet në politikën dhe shoqërinë kosovare për momentet kritike që kalon vendi. Konjunkturalisht zgjedhjet i kanë këto rreziqe. Mbetet në dorë të politikës dhe të institucioneve aktuale të Kosovës të vendosin për zgjedhjen e njëjës prej këtyre dy alternativave: kompromis të madh politik e institucional ose zgjedhje të parakohshme për konstituimin e legjitimitetit të organeve qeverisë në Kosovë. Nga alternativa e zgjedhur do varet shumë stabiliteti dhe zhvillimi në Kosovë, ecuria e procesit të Hagës si dhe vijimi i dialogut me Kosovë-Serbi për normalizimin e marrëdhënieve midis tyre.

# Të mbrohen vlerat e luftës së



**Shkruan: Nuhi BYTYÇI**

Të gjithë kemi besuar në drejtësinë ndërkombëtare dhe askush nuk ka menduar se ajo do të merret vetëm me nxjerrjen në bankën e të akuzuarve vetëm të pjesëtarëve të një enie, të cilët kanë luftuar për liri dhe kanë qenë viktimat. Tashmë jemi

dëshmitarë se akuzat kryesore e Rezolutës për formimin e Gjykatës Speciale të iniciuar nga senatori Dick Marty dhe miratuar nga Këshilli i Evropës për ndriçimin e "trafikimit të organeve nga UÇK-ja" nuk përmendet askund në aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Hagës ndaj krerëve të UÇK-së. Ngritja e aktakuzës ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Prokuroria e Dhomave të Specializuara të Kosovës, sipas mendimit tim, është bërë bazuar në disa akuzat të fabrikuara nga ish-regjimi dhe regjimi aktual i Serbisë dhe bashkëpunëtorët e tyre. Sipas tyre, pretendohet se

nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me akuzën se të akuzuarit paskan bërë "ndërmarrje të përbashkët kriminale, kryer krime të luftës, të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, të burgosjes, akteve të tjera çnjerëzore, të torturës, të vrasjes së paligjshme, të zhdukjes me forcë të personave dhe përndjekjes të civilëve serbë, romë, ashkalinj, katolikë, anëtarë të LDK-së dhe të partive të tjera". Padyshim kjo është një ndër akuzat më të rënda ndaj të një ushtrie e cila zhvilloi luftë të drejtë

dhe të shenjtë për liri dhe pavarësi të popullit të Kosovës. Akuzat e tillë është fyerja dhe njollosja më e pashembullt që u bëhet çlirimtarëve dhe popullit të Kosovës që e mbështeti luftën e UÇK-së, por edhe të faktorëve relevantë ndërkombëtarë, miqve tanë ndërkombëtarë, që ndihmuan për çlirimin e Kosovës nga regjimi militarist e gjenocidal i Serbisë në krye me Sllobodan Millosheviqin dhe largimin përfundimtar të administratës serbe nga Kosova. Përpjekjet për balancimin, barazimin e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe krimeve që ka bërë regjimi okupues serb,

amnistimi dhe përkëdhelja e Serbisë, janë në kundërshtim me të gjitha normat pozitive të drejtësisë ndërkombëtare dhe kontribuojnë në destabilizimin e shtetit të Kosovës dhe të rajonit. Ndërtimi i aktakuzës nga dosjet e Prokurorisë së Serbisë dhe të disa shërbëtorëve të saj në Kosovë është nxitur nga disa qarqe antishqiptare dhe antiamerikane, që u vunë në agjendën e shërbimeve serbe dhe ruse në Ballkan. Kjo padyshim është pjesë e skenarëve të regjimit aktual serb, që është vazhdimësi e ish-regjimit kriminal të Millosheviqit kundër shtetit të ri të Kosovës. Synimi për

# Gjashtë faktet që nuk i merr parasysh Gjykata Speciale



Shkruan: Adnan ASLLANI

Pesë vjet më parë Kuvendi i Kosovës, pas një trysnie të pashembullt mbi deputetët, miratoi ndryshimet kushtetuese, me të cilat u mundësua themelimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës apo, siç njihet tashmë, me emërtimin "Gjykata Speciale".

Pas një hetimi të gjatë, ajo tashmë ka ngritur aktakuzat e para dhe ka prangosur, ndër të tjerë, edhe presidentin e Kosovës dhe dy ish-kryetarë të Kuvendit të Kosovës në legjislatura të ndryshme. Në një lexim të shpejtë të aktakuzave të para, mund të vish në këto përfundime:

## E para:

Themelimit të Gjykatës Speciale i ka paraprirë raportit që mban emrin e politikanit zviceran Dick Marty e që, në fakt, është një sajese e shërbimit të fshehtë serb, të cilin ai e ka pranuar përmes ambasadorit të Serbisë në Zvicër, Milan St. Protiq. Mbi UÇK-në u ngrit një mal me akuzat, e më e rënda prej tyre kishte të bënte me tregtimin e organeve njerëzore. Pretendohej se serbëve të zënë rob, UÇK-ja ua paska hequr organet dhe i paska shitur ato në treg, sikur ato të kishin qenë pjesë këmbimi për makina. Dëmi që iu bë Kosovës dhe pavarësisë së saj është i pallogaritshëm. Asnjë nga këto pretendime nuk figurojnë në aktakuzat e ngritura deri më tani nga Gjykata Speciale. Megjithatë edhe pse dështimi i faktimit të

këtyre akuzave është pritur nga shumëkush, ato kanë arritur efektin për të cilin edhe janë lansuar. Kosova për pesë vjet rresht është mbajtur në bankë të të akuzuarave, pasi mbi UÇK-në rëndonin dyshime për krime më të tmerrshme të dëguara ndonjëherë. Ky efekt vazhdon ta rëndojë shtetin e ri të Kosovës, pasi ende asnjë gjykatë nuk ka treguar se ato akuzat ishin fabrikime.

## E dyta:

Nga aktakuzat e publikuara deri më tani duket qartë që Gjykata Speciale nuk e merr parasysh historinë e Kosovës, përkatësisht nuk i merr parasysh shkaqet që çuan deri te themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo nuk i njeh rrethanat e aparteidit që mbretëronin në Kosovë në fillim të viteve '90. Nuk e merr parasysh jetën e padurueshme në Kosovën e pushtuar, në të cilën fakti se kishe lindur shqiptar përbente një sfidë të vërtetë të jetës, meqë përballeshe me diskriminim, përndjekje, burgosje e me shumë lehtësi edhe mund të vriteshe pa dhënë llogari askush për këto. Kosova nuk u trajtua në asnjë konferencë ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Statusi i saj ishte ulur në nivelin e respektimit të të drejtave të njeriut, për të cilin flisnin organizatat humanitare, por më shumë se kaq nuk kishte ndonjë lëvizje serioze. Lindja e UÇK-së ka qenë një domosdoshmëri e kohës në luftën tonë për mbijetesë.

## E treta:

Ta trajtosh UÇK-në si ndërmarrje e përbashkët kriminale do të thotë ta mohosh luftën për liri. E pafalshme është kur UÇK-ja trajtohet sikur të ishte një bashkim mafioz për t'i eliminuar kundërshtarët politikë me qëllim kriminal.

Kjo është e papranueshme dhe për këtë gjë institucionet e Kosovës duhet të flasin shumë zëshëm. UÇK-ja është bashkim i njerëzve liridashës, me qëllimin më fisnik e idealin më të lartë për liri. Ta trajtosh këtë organizim si kriminal, nuk ka fyerje më të rëndë për të gjithë ata pjesëtarë të saj, një pjesë e madhe e të cilëve kanë rënë në luftë me idealin më të lartë për liri, si Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Fehmi Lladrovci, Bekim Berisha etj.

## E katërta:

Kur në aktakuzë përmenden grupet që paskan qenë target i kësaj "ndërmarrje kriminale" flitet për serbë, romë dhe katolikë. Kjo është pikërisht ajo që makineria propagandistike serbe ka proklamuar e përsëritur në vazhdimësi, me qëllim që t'i fshehë arsyet e vërteta të kryengritjes dhe ta paraqesë këtë sikur UÇK-ja është një organizim kriminal, me orientim fundamentalist islamik, që ka për qëllim eliminimin e katolikëve e pjesëtarëve të besimeve të tjera fetare. E neveritshme është kjo akuzë kur kihat parasysh se pjesëtarë të UÇK-së kanë qenë pa dallim feje e ideologjie. Një numër i madh i atyre pjesëtarëve kanë qenë pikërisht të besimit katolik. E dihet botërisht se UÇK-ja nuk ka pasur në shënjestër civilët, por forcat okupuese serbe të cilat po e mbanin Kosovën nën pushtim dhe po bënë spastrimin etnik të saj.

## E pesta:

Gjykata Speciale nuk i merr parasysh vrasjet e mbi dhjetë mijë shqiptarëve, dhunimet seksuale të mbi njëzet mijë femrave shqiptare, spastrimin etnik të Kosovës me dëbimin e shumicës dërrmuese të shqiptarëve dhe asgjësimin e dokumenteve të


identifikimit, shkatërrimin e 100 589 shtëpive, të 88 101 objekteve përcjellëse, të 358 shkollave, të 30 shtëpive kulturore, të monumenteve historike, të 93 bibliotekave, të 123 institucioneve shëndetësore dhe të 220 objekteve të kultit fetar (xhami, teqe, tyrbe dhe kisha katolike). Me një fjalë, Gjykata Speciale nuk e merr parasysh gjenocidin që forcat serbe kanë ushtruar në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Të gjitha këto fakte i obliguan shtetet demokratike perëndimore, të prira nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që të ndërhyjnë ushtarakisht, në mënyrë që ta ndërpresin gjenocidin ndaj shqiptarëve.

## E gjashta:

Gjykata Speciale është themeluar t'i gjykojë vetëm shqiptarët, pra ata që kanë qenë viktime të këtij gjenocidi, kurse kriminelët e vërtetë, përgjegjës për krime monstruoze ndaj shqiptarëve,

politikanë dhe ushtarakë në Serbi që drejtojnë shtetin serb sot, i amnistion. A ka një rast tjetër në botë ku një gjykatë mund të mos marrë në përgjegjësi një kriminel, meqenëse ai i takon një etnie tjetër?

Është vërtet për t'u çuditur se si është e mundshme që në Evropën e të drejtave të barabarta të ketë mundësi të funksionojë një gjykatë e tillë diskriminuese në bazë etnike. Mosmarrja parasysh e këtyre fakteve nga Gjykata Speciale, e themeluar nga institucionet e Kosovës si pjesë e legjislacionit të saj, është një fyerje e rëndë për të gjitha viktimat e gjenocidit. Mesazhi që përçohet me këtë rast përbën një precedent që nuk guxon të anashkalohet: Pa njohjen dhe dënimin e gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë nuk mund të ketë kurrë pajtim e as drejtësi, mbi të gjitha nuk mund të ketë garanci se në të ardhmen kjo nuk do të përsëritet.



## shenjta të UÇK-së

margjinalizimin dhe, para së gjithash, për kriminalizimin e luftës së shenjta të popullit të Kosovës udhëhequr nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, largimi nga scena politike dhe publike e Kosovës e krerëve të UÇK-së dhe të shtetit të Kosovës, janë pjesë e skenarëve të kamotshëm të disa qarqeve anti-UÇK dhe anti-Kosovë. Po të ishte gjallë edhe komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari, me siguri se edhe emri i tij do të ishte në mesin e të akuzuarve. Dihet se burimi i akuzave është pikërisht në Beograd, i cili nuk i ka dënuar kryesisht kryesorët të krimeve mbi shqiptarët në Kosovë, ende nuk ka

kërkuar falje për krimet e bëra ndaj civilëve shqiptarë dhe vazhdon t'i mohojë ato dhe po i fsheh gjurmët e krimeve të luftës. Gabimet në shtetbërje, e sidomos përçarja e faktorit politik shqiptar dhe defaktorizimi i tij në Ballkan, pikërisht në momentin kur është dashur që ai të unifikohet dhe të veprojë me një strategji të përbashkët dhe largpamëse për ta rrumbullakuar procesin e ndërtimit të shtetit demokratik të Kosovës dhe të njohjes ndërkombëtare të tij, ka ndikuar që pikërisht tani edhe Prokuroria Speciale t'i ngrehë aktakuzat ndaj krerëve të UÇK-së, gjë që ka gëzuar kundërshtarët e shtetit të

pavarur të Kosovës. Prandaj, bartësit aktualë të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe liderët e të gjitha forcave politike shqiptare të Kosovës, por edhe të Shqipërisë, duhet të unifikohen dhe ta hartojnë strategjinë e bashkëveprimit si komb me qëllim të kundërshtimit të tendencave për destabilizimin e Kosovës, që ta mbrojnë sakrificën sublime të popullit të Kosovës, t'i mbrojnë vlerat e lirisë dhe të shtetit të ri të Kosovës. Kosova e ka paguar shtrenjtë çmimin e lirisë. Tani është koha që projekti i lirisë dhe shtetit t'i hiqet mjegulla që pengon ecjen përpara. Vlerat e luftës së shenjta të UÇK-së nuk



duhen lejuar që të njollosen nga askush. Ashtu si kanë sakrifikuar, madje edhe duke qenë të gatshëm që edhe të flijohen për lirinë e saj, jam i bindur se krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do ta fitojnë edhe betejën përfundimtare para drejtësisë

ndërkombëtare. Bota e di se shqiptarët nuk ishin kriminelë, por viktime. Prandaj, viktimat nuk duhet të ndëshkohen sërish, as të nëpërkëmben, sepse e ardhmja duhet të ndërtohet mbi themele të shëndosha, humane dhe të qëndrueshme.

## Asfaltohen mbi 8 kilometra rrugë në qytetin dhe fshatrat e Klinës

**KLINË, 6 NËNTOR (ER)** - Në kuadër të investimeve komunale për përmirësimin e infrastrukturës rrugore janë duke vazhduar punimet për asfaltimin e rrugëve në qytetin e Klinës, të cilat kanë një gjatësi prej 4699.75 metrash dhe rrugëve në fshatrat Ujmirë, Shtaricë dhe Siqevë, të cilat kanë një gjatësi prej 3 935.14 metrash. Realizimin e punimeve e kanë përcjellë nga afër kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, bashkë me drejtorin e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Lorenc Marleku, dhe atë të Administratës, Binak

Sylaj. Elezaj ka uruar qytetarët për realizimin e këtyre projekteve, të cilat do të ndikojnë në ofrimin e sigurisë më të madhe në qarkullim dhe ka theksuar se komuna do t'i vazhdojë investimet e njëjta edhe në lokalitete të tjera, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës. Projekti për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Ujmirë, Shtaricë dhe Siqevë ka një kosto buxhetore prej 126 669 eurosh, ndërsa projekti për asfaltimin e rrugëve në qytet ka një vlerë buxhetore prej 159 532 eurosh.



## Podujeva, memorandum bashkëpunimi me organizatën "Mëshqerra"



**PODUJEVË, 6 NËNTOR (ER)** - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me drejtoreshën e Organizatës për Zhvillim Rural "Mëshqerra", Florentina Kida-

Gërguri, për mbështetjen e fermerëve të kësaj komune me 45 krahë lopë të racës "Hollishtajn". Sipas këtij memorandum, projekti do të jetë trevjeçar. Nën kryetari Rudari ka thënë se do t'i

vazhdojnë projektet konkrete në fushën e blegtorisë në vitin e ardhshëm dhe do t'i mbështesin gjithmonë fermerët llapjanë përmes subvencioneve, granteve dhe projekteve të ndryshme bujqësore.

## Fillon renovimi i dy nënkalimeve në lagjen 'Kalabria'

**PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER)** - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se kanë filluar punimet për renovimin e dy nënkalimeve në lagjen "Kalabria", në mënyrë që të rregullohen dhe të funksionalizohen për t'u shfrytëzuar nga qytetarët. "Pas

përfundimit të nënkalimit në 'Kalabri' do të fillojnë renovimet e nënkalimeve të Xhamia e Llapit dhe në Bardhosh. Shfrytëzimi i nënkalimeve ndikon në rritjen e sigurisë të këmbësorëve në trafikun rrugor", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



## Hapet ekspozita 'Mitrovica Print 2020'

**MITROVICË, 6 NËNTOR (ER)** - Në ambientet e Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica", buzë lumit Ibër, është bërë hapja e ekspozitës së Bienales së parë Ndërkombëtare të Grafikës "Mitrovica Print 2020", ku janë ekspozuar punimet artistike të 60 artistëve nga 15 shtete të botës.

Në praninë e shumë artdashësve, artistëve dhe qytetarëve, hapjen e kësaj ekspozite e ka bërë nënkryetari i Mitrovicës, Faruk Mujka, i cili e ka cilësuar këtë ekspozitë të një rëndësie të veçantë, të nivelit ndërkombëtar e të pasuruar me vlera dhe vepra të larta artistike. "Ky eveniment mund të cilësohet si një nga aktivitetet më të rëndësishme në fushën e kulturës dhe artit pamor sepse sonte po i shohim punimet artistike të më se 60 artistëve

nga 15 shtete të botës. Dua t'i përgëzoj të gjithë artistët për rolin dhe kontributin e tyre andaj shpresoj që ky organizim të jetë i përvjetshëm e shpresoj që viti i ardhshëm të jetë akoma më madhor sepse të gjithë jemi dëshmitarë që shfaqja e pandemisë në këtë vit e ka kufizuar punën në shumë fusha", ka thënë Mujka.

Ndërsa drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, pasi ka folur për rëndësinë e kësaj ekspozite, si të parën e llojit të tillë në Kosovë, ka falënderuar të gjithë artistët ndërkombëtarë të cilët e kanë begatuar këtë ekspozitë dhe qytetin e Mitrovicës me vepra artistike.


Juria profesionale, pasi ka shqyrtuar të gjitha punimet e ekspozuara me rastin e Bienales së Parë Ndërkombëtare të Grafikës



"Mitrovica Print 2020", ka ndarë çmimin e parë për Fatmir Krypa nga Kosova, çmimin e dytë për artistët Silvia Beruezo nga Argjentina dhe Agata

Perzynski nga Polonia, ndërsa çmimi i tretë është ndarë për Kalina Milanova nga Bullgaria dhe Shpend Bengu nga Shqipëria.

Bienala Ndërkombëtare e Grafikës është mbështetur nga Komuna e Mitrovicës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmenden në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, sllovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.



Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pottuajste askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbremjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkani, Ali Podrimja dhe botuar nga *Rilindja* më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: *Boshnjakët edhe mund ta barrojnë luftën, edhe ta barrojnë Sarajliqin, por ne s' do ta barrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s' do ta barrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s' do ta barrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetëm atje, ne shqiptarët këtu.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €




## PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



**IZET SARAJLIQ**

Përkthet: Salajdin Salihu  
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Shtyhen ndeshjet e basketbollit



©Basketball Federation of Kosovo  
Foto: Shpend Ahmeti

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) njofton të gjitha klubet anëtare të saj se, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 6 nëntor prej të premtës, të shtunën e të dielën nuk do të zhvillohen ndeshjet e basketbollit të parapara me kalendarët e garave, më saktësisht nuk do të zhvillohen aktivitetet sportive në palestra. Qeveria e Republikës së Kosovës të premtën e ka publikuar vendimin që ndalon veprimtarinë e të gjitha subjekteve afariste dhe bizneseve, qendrave tregtare e rekreative, supermarketeve, subjekteve që ofrojnë shërbimet e gastronomisë në tërë

territorin e Kosovës nga sot në orën 20:00 e deri të hënën në orën 05:00. Në pikën 2 të vendimit të sotëm të Qeverisë së Kosovës thuhet: "Pezullohen paragrafët 7, 8, 11, 12, 13, 14, 20 e vendimit të qeverisë 01/39 të datës 01.11.2020 deri në kohën e përcaktuar sipas dispozitivit 1 të këtij vendimi". Pra, vendimi i Qeverisë së Kosovës pezullon edhe pikën 12 të një vendimi të 1 nëntorit, që thotë: "Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura, stërvitjet dhe garat mund të organizohen në sportet individuale; në hapësirat e mbyllura, gjatë stërvitjes, mund të marrin pjesë deri në 20

persona, ndërsa në organizimin e garave mund të marrin pjesë deri në 50 persona, bazuar në protokolle dhe udhëzime vendore dhe ndërkombëtare sportive, të bazuar në manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19. Matja e temperaturës është e detyrueshme gjatë hyrjeve në objekte të mbyllura sportive si dhe në hapësirat e hapura sportive". Federata e Basketbollit e Kosovës njofton të gjitha klubet anëtare të saj, si dhe gjithë komunitetin e basketbollit dhe opinionin e gjerë, se në bashkëpunim me institucionet e vendit në ditët në vazhdim do të bëjë të ditur ecurinë e garave të saj.

## SHKURT

### Mojeed Ewuosho, MVP i xhiros së tretë në basketboll

Sfidat e xhiros së tretë në Prince Caffë Superligën e Kosovës kanë dhuruar ndeshje të bukura dhe dramatike. Trepça dhe Vëllaznimi kanë shënuar fitoret e para në elitë, duke mundur Golden Eagle Yllin, përkatësisht Bashkimin. Lojtari më i dalluar i mitrovicasve në fitoren ndaj Yllit ishte Mojeed Ewuosho me 20 pikë, 8 kërcime e 7 asistime, me një efektshmëri 23. Mojeed Ewuosho u tregua vendimtar në periudhën e fundit, ku sfida ishte shumë dramatike dhe ndihmoi skuadrën e tij ta shënojë fitoren e parë në këtë edicion. Që nga arritja në Trepçë ka treguar lojërë mjaft të mira.

### Futbollisti i Kosovës U21, në mesin e talentëve më të mëdhenj në Suedi

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës U21, Erion Sadiku, po llogaritet një nga talentët më të mëdhenj në futbollin suedez. 18-vjeçari është pjesë e Valbergut në Superligën e Suedisë dhe këtë sezon në 21 paraqitje ka shënuar dy gola. Media e njohur suedeze 'FutbollDirekt' ka cilësuar Sadikun si talentin e 13-të më të mirë në Superligën e Suedisë. "Një mesfushor që shkon nën radar. Lojtari i Kosovës është një mesfushor i klasës së mirë në Allsvenskan, duke marrë parasysh moshën e tij. Një pjesë e rëndësishme e suksesit të Varbergs", thuhet në përshkrimin që i bëhet lojtarit.

### Gjimshiti: Liverpooli, i fortë për Atalantën

Skuadra e Atalantës ka pësuar humbje të thellë nga Liverpooli (0-5) në kuadër të xhiros së tretë në Ligën e Kampionëve. Qendërmbrojtësi i Atalantës, Berat Gjimeshiti, ka thënë se Liverpooli ishte shumë i fortë për skuadrën e tij. "Liverpooli ishte shumë i fortë për ne, por nuk ia bëmë edhe aq të vështirë. Ne nuk luajtëm mirë në të gjithë aspektet, me shumë gabime individuale. Kështu humbet ndaj skuadrave të tilla. Ishim gati dhe të motivuar, më pas shkuam në disavantazh dhe, ndoshta, humbëm ekuilibrin", ka thënë Gjimeshiti.

## Dy derbi në Superligë

Prishtinë, 6 nëntor - Superliga e Kosovës në futboll pritet të vazhdojë javën e dymbëdhjetë pasi Qeveria e Kosovës nuk i ka ndaluar aktivitetet sportive në

ambient të hapur. Sot (e shtunë) do të zhvillohet ndeshja e parë në mes të Arbërisë dhe Besës së Pejës, kurse tri ndeshje do të

zhvillohen nesër (e diel), ku dy prej tyre janë derbi. Lideri aktual, Ballkani, e pret skuadrën e Gjilanit në Suharekë, kurse Prishtina është mysafire e

Dritës në Gjilan. Llapi luan ndaj Trepçës '89. Të hënën mbyllet kjo xhiro me ndeshjen Drenica - Feronikeli. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 13:30.



## Ronaldo e fton Di Marian në Juventus

TORINO, 6 NËNTOR - Cristiano Ronaldo e ka ftuar te Juventus, Angel di Marian, një prej shokëve më të mirë në periudhën e Realit të Madridit, të cilit i kalon

vlefshmëria e kontratës me PSG-në në qershor 2021 dhe, me sa duket, as argentinasi dhe as francezët nuk duan që ta vazhdojnë më tej

bashkëpunimin. Për këtë arsye, Ronaldo i ka bërë një ftesë sulmuesit anësor argentinasi që t'i bashkohet te "Zonja e Vjetër". Sigurisht se edhe kampionët e Italisë

mund ta marrin shumë seriozisht këtë mundësi, duke parë se Di Maria do të zbarkonte në Torino me parametër zero dhe nuk kërkon një rrogë të madhe.



## Duka: Koronavirusi ndaloi Kupën e përbashkët në mes të Shqipërisë dhe Kosovës

TIRANË, 6 NËNTOR - Basketbolli e ka bërë konkretizimin për bashkimin mes Shqipërisë dhe Kosovës në sport, ndërsa në krahun tjetër edhe futbollit e ka ideuar prej një kohësh një shkrije të tillë. Ajo që është projektuar nga ana e FShF-së dhe FFK-së është krijimi i një kupe të përbashkët, për të lënë një çmim të lartë për fituesin që ekipet të luajnë seriozisht dhe të merret më e mira prej ndeshjeve. Gjithashtu po kërkohej edhe tek UEFA që fituesi të kishte edhe një biletë në Evropë, për ta rritur më tepër konkurrencën. Ndërkohë Armand Duka ka pritur në ditën e sotme kryetarin e FFK-së, Agim Ademi, atje ku është folur edhe për këtë projekt të përbashkët. Sipas asaj që raporton "Balkanweb", Duka e ka nisur fjalimin e tij duke u shprehur se kjo nuk është një



ditë e bukur për shqiptarët pasi disa nga drejtuesit e UÇK-së ndodhen para drejtësisë në Hagë. "Jam i gëzuar që prita presidentin e Federatës së Kosovës, te zyrat dhe në stadium, si dhe gjithë anëtarët e FFK-së, me të cilët e kishim lënë. Ishte një vizitë e programuar. Megjithatë kjo nuk është një ditë shumë e

bukur për ne shqiptarët, për ngjarjet që kanë ndodhur dje, për disa nga drejtuesit e UÇK-së të cilët kanë shkuar para drejtësisë në Hagë. Projekti madhor ishte organizimi i një Kupe të përbashkët, e cila nuk u kurorëzua për arsye të Covidit. Është objektiv që ta realizojmë në vitet në vazhdim", ka thënë Duka.

## Publikohet lista e Kosovës U21



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës U21, Rafet Prekazi, e ka publikuar listën e futbollistëve për dy ndeshjet e radhës në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian U21, kundër Shqipërisë, më 13 nëntor në stadiumin "Fadil

Vokrri" dhe kundër Turqisë, më 17 nëntor në Samsun. Stërvitja e parë e "dardanëve" të rinj do të jetë të hënën më 9 nëntor, në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas në orën 14:00. Lista e futbollistëve: F. Smakiqi, D. Bisinger, A. Nika, A.

Kapra, L. Sadriu, E. Kurtulus, V. Zumberi, B. Pllana, L. Vitija, D. Bajselmani, A. Shabani, V. Hamdiu, A. Zekaj, E. Kqiku, Q. Zyba, M. Jashari, B. Baftiu, D. Rudhani, G. Limani, D. Berisha, B. Idrizi, A. Ajdini, K. Selmani, F. Seferaj, V. Mustafa.

### SHKURT

#### Rossi fitoi betejën me Covid-19

Valentino Rossi fiton betejën më të rëndësishme deri tani në jetë, atë me Covid-19. Që prej 15 tetorit "Doktori" qëndronte në karantinë pasi ishte infektuar nga koronavirusi, duke humbur edhe 1 garë të Moto Gp por, së fundmi, italiani e ka mposhtur Covid-19. Piloti italian i garave të shpejtësisë, 9 herë kampion bote, ka dalë negativ, duke marrë më në fund përgjigjen që priste prej një kohe të gjatë. 41-vjeçari ka fluturuar menjëherë drejt Valencias, aty ku do të mbahet Çmimi i Madh këtë fundjavë. Nëse këtë të premte del sërish negativ, Rossi mund të garojë në pistë të dielën. Në këtë sezon të Moto Gp, Valentino Rossi pozicionohet në vendin e 15-të të klasifikimit të përgjithshëm me 58 pikë të grumbulluara.

#### Arabia Saudite pret një garë të Formulës 1 në vitin 2021

Arabia Saudite njoftoi se do ta presë garën për Çmimin e Madh të Formulës 1 në qytetin e saj bregdetar, Jeddah, në nëntor të vitit 2021. Duke njoftuar garën në një ceremoni, ministri i Sportit, Abdul Aziz bin Turki Al Faisal, ka thënë se kjo ngjarje e profilit të lartë do ta rrisë numrin e turistëve në Mbretëri. "Mirë se vini në Formula 1 dhe mirë se erdhët te kampionët!", ka thënë Princi Abdul. Ai bëri me dije se gara do ta ndihmojë Mbretërinë të bëhet një qendër për ngjarjet sportive ndërkombëtare. Gara do të mbahet në Mbretëri si pjesë e partneritetit 15-vjeçar mes Formula 1 dhe Federatës Saudite të Automjeteve dhe Motoçikletave.

#### Mourinho: Unë dhe Muller dukemi si 'pleq' shkaku i fitoreve të hershme

Jose Mourinho dhe Thomas Muller kanë një të përbashkët, kanë filluar të fitojnë trofe dhe të jenë të suksesshëm në moshë shumë të re. "Special One" në rolin e trajnerit dhe sulmuesi gjerman me Bayern Munchen dhe kombëtaren e "Pancerave". 41 vjeç ishte trajneri portugez kur fitoi Champions League me Porton në vitin 2004, teksa Thomas Muller ka fituar shumë trofe dhe ka vendosur rekorde fantastike me Bayernin. Mourinho ka folur rreth sukseseve në moshë të re në futboll, duke bërë një krahasim me 31-vjeçarin gjerman. "Kur arrin suksesin në futboll në moshë të re, njerëzit e harrojnë moshën tënde. Unë ndihem njësoj si Thomas Mulleri. Ka raste kur njerëzit mendojnë se jam 75 vjeç, por jam vetëm 57. Thomasi nuk është i vjetër (gjermani është 31 vjeç). Ai, thjesht, u bë i suksesshëm në këtë sport në moshë shumë të re", ka deklaruar trajneri i Tottenhamit.

#### Trajneri i Suedisë, Ibrahimoviçit ia mbyll dyert e rikthehet në Kombëtare

Janne Andersson, trajneri aktual i Suedisë, i intervistuar nga gazeta "Aftonbladet" në lidhje me postimin në rrjetet sociale të Zlatan Ibrahimoviçit, që u interpretua si dëshirë e sulmuesit veteran për ta riveshur fanellën e përfaqësueses nordike, sqaroi se e ka mbyllur njëherë e mirë këtë çështje. "Disa njerëz më thanë se pas asaj fotografie kishte një plan, por nuk e kuptoj se çfarë do të thotë, nuk dua të harxhoj shumë energji për këtë. Kanë kaluar katër vjet e gjysmë që kur ai tha se e kishte mbaruar karrierën e tij në ekipin kombëtar. Ne biseduam pas Kampionatit Evropian. Janë shumë lojtarë që kanë marrë të njëjtin vendim dhe unë kam respektin më të madh për ta. Pra, çështja është mbyllur për mua", ka thënë Andersson.

## Historike, pas 50 vjetësh, asnjë futbollist i Benficës dhe Sportingut në listën e Portugalisë

Fernando Santos i surprizon të gjithë. Trajneri i Portugalisë ka publikuar listën me emrat e 25 futbollistëve të grumbulluar për tri sfidat e

muajit nëntor, miqësoren ndaj Andorrës dhe takimet e Nations League ndaj Francës dhe Portugalisë, ku bie në sy fakti se pas 50 vjetësh në një

grumbullim të kombëtares luzitane, nuk ka asnjë futbollist të Benficës dhe Sportingut, dy skuadrave të Lisbonës që historikisht kanë

furnizuar me futbollistë Portugalinë. Në listën e publikuar nga Santos bëjnë pjesë emra të rëndësishëm si Cristiano Ronaldo, Joao Felix,

Bernardo Silva, Diogo Jota, Bruno Fernandes, William Carvalho, Joao Cancelo, Ruben Dias apo edhe Rui Patricio.

04.11.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

Numri i lëndës: 2020:091791  
 Datë: 02.11.2020  
 Numri i dokumentit: 01233485

**C.nr.535/20**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**, me gjyqtarin Besnik Bislimaj dhe me zyrtareshen ligjore Merita Xharavina, në çështjen juridike të paditësit Marash Pal Krasniqi nga fsh.Meqe, Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Ergjymet Barbullushi av, nga Gjakova, kundër të paditurës Jana Soldatova nga Skenderaj rr,"Adem Shala", tani me banim në adresë të panjohur, për shkak të zgjidhjes së martesës, me datë 02.11.2020 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Të paditurës Jana Soldatova e vaj.Soldat nga Republika Çeke, tani me adresë të panjohur, **iu CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokati Ilir Rogova nga Gjakova.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe tabelën e shpalljeve të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Paditësi Marash Pal Krasniqi nga fsh.Meqe, Komuna e Gjakovës, pranë kësaj gjykate me datë 12.04.2019, ka parashtruar padi për shkak të zgjidhjes së martesës, kundër të paditurës Jana Soldatova e vaj.Soldat nga Republika Çeke, tani me adresë të panjohur.

Gjykata me aktvendim të dt.04.09.2020 ka obliguar paditësen që në afat prej 3 dite, të gjejë adresën e saktë të të paditurës Jana Soldatova e vaj.Soldat nga Republika Çeke, i autorizuari i paditësit Ergjymet Barbullushi av, nga

Numri i lëndës: 2020:091791  
 Datë: 02.11.2020  
 Numri i dokumentit: 01233485

Gjakova, me parashtrësën e dt.10.09.2020, ka njoftuar gjykatën se pas ndarjes faktike ajo është larguar në drejtim të panjohur. Edhe pse pas shumë përpjekjeve që të mësojë së paku për adresën e saj nuk kemi arritur që të mësojmë asgjë, andaj, ka lutur gjykatën se për të paditurën të caktoj përfaqësuesin e përkohshëm.

Gjykata duke pasur parasysh se e paditura nuk gjendet në adresën e cekur si në padi dhe se i autorizuari i paditësit nuk ka ofruar adresë të saktë të të paditurës dhe meqenëse, nuk mund të zhvillohet procedura në këtë adresë pasi që e njëjta nuk gjendet në atë adresë, me aktvendim C.nr.535/20 të dt.13.10.2020 ka detyruar të autorizuarin e paditësit Ergjymet Barbullushi av, nga Gjakova, në fat prej 3 dite, të bëjë pagesën në shumë prej 400.00.-€, në emër të paradhënies për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, meqenëse, të paditurës nuk i dihet adresa e saktë, dhe paditësi është i lajthitur sa i përket kësaj adresë për të paditurën, andaj, gjykata për të vepruar me këtë çështje kontestimore konstaton se të paditurës Jana Soldatova e vaj.Soldat nga Republika Çeke, duhet t'iu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Andaj, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit të lartë cekur.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C.nr.535/20 të datës 02.11.2020**

Gjyqtar,  
**Besnik Bislimaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

(CERTIFIED TRANSLATION FROM ALBANIAN INTO ENGLISH)

(Emblem of Kosovo)  
**REPUBLIC OF KOSOVO**

Case Number: 2020:091791  
 Date: 2<sup>nd</sup> November 2020  
 Number of Document: 01233485

**C. No. 535/20**

**THE BASIC COURT GJAKOVË**, respectively Judge Besnik Bislimaj and legal officer Merita Xharavina, regarding the juridical matter of the Plaintiff Marash Pal Krasniqi from Meqe village, Gjakovë municipality, represented by the authorized attorney-at-law Ergjymet Barbullushi from Gjakovë, against the Defendant Jana Soldatova from Skenderaj, "Adem Shala" Street, currently with unknown address, regarding the divorce of marriage, on 2<sup>nd</sup> November 2020 took this

**OFFICIAL DECISION**

For the Defendant Jana Soldatova, maiden surname Soldat, from the Czech Republic, currently with unknown address, **is appointed** the temporary representative Ilir Rogova, attorney-at-law from Gjakovë.

In accordance with Article 82 of the Law of Contestable Procedure (LPK), the temporary representative has all entitlements and duties of a legal representative who will exercise them until the defendant or her proxy has appeared at court, respectively until the guardianship authority notifies the court on appointing a guardian.

This Official Decision will be announced on the official newspaper, on one of the daily newspapers as well as on the board of announcements of the court.

**Justification**

The Plaintiff Marash Pal Krasniqi from Meqe village, Gjakovë municipality, has filed a lawsuit for divorce of marriage on 12<sup>th</sup> April 2019 against the Defendant Jana Soldatova, maiden surname Soldat, from the Czech Republic, currently with unknown address.

The court, with the decision of 4<sup>th</sup> September 2020, obliged the plaintiff to find the exact address of the defendant Jana Soldatova, maiden surname Soldat, from the Czech Republic within 3 days, and the authorized representative of the plaintiff Ergjymet Barbullushi, lawyer from Gjakovë, with the submission dated 10<sup>th</sup> September 2020, has notified the court that after the factual separation she has left in unknown direction. Although after many attempts to find out at least her address, he failed to learn anything, therefore, he requested from the court to appoint a temporary representative for the defendant.

Case Number: 2020:091791  
 Date: 2<sup>nd</sup> November 2020  
 Number of Document: 01233485

Having in mind that the Defendant is not located on the mentioned address as in the Lawsuit and that the Plaintiff hasn't provided the correct address of the Defendant, and since the proceedings can't be developed, the Court, by Official Decision C. No. 535/20 of 13<sup>th</sup> October 2020, has obliged the authorized of the Plaintiff Ergjymet Barbullushi from Gjakovë, within a term of 3 days, to execute the payment in the sum of 400,00 Euros on behalf of the advance payment for the expenses of the temporary representative because the address of the Defendant is unknown, and the Plaintiff, being in a condition of err because of the unknown address of the Defendant, therefore, the Court has acted in this matter of contest by ascertaining that the Defendant Jana Soldatova, maiden surname Soldat, from the Czech Republic shall have a temporary representative appointed.

The Court found that the conditions from Article 79.3 of LPK are fulfilled needed for the appointment of temporary representative for the above mentioned defendants.

As said above, it was decided as in the provision of this official decision.

**THE BASIC COURT GJAKOVË**  
**C. NO. 535/20, OF THE DATE 2<sup>ND</sup> NOVEMBER 2020**

Judge,  
**Besnik Bislimaj (Signed)**

(Round Seal)  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 BASIC COURT GJAKOVË

**Juridical Counseling:** No appeal is allowed against this decision.

No.: 1233-11/20  
 Gjakovë, on 5<sup>th</sup> November 2020

That this translation is true to its original is certified by:



*Prof. Agim Byci*

**Prof. Agim Byci**  
 SWORN COURT TRANSLATOR  
 for the English language  
 tel.0390/20 106 GJAKOVË



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Bahceci Fertility International” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811400118 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bahceci Fertility International” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811400118, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Bahceci Fertility International” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811400118 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr. 13/696  
Më: 06.11.2020  
Dragash

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parashikuar në Republikën e Kosovës nr.04/L-053, nëntë 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.09/L-212, nëntë 5 të Ligjit për Arsimin në Krahunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.18/2018 të datës 30.07.2018 për normativin mbi kandidat profesional të arsimit të përgatishës. Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normarivi për mësimdhënës të arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimit të MASHT nr.33/01B, vendimit të MASHT nr.231/01B të datës 04 Gashi 2017, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016, Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, sapel:

### KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parashikuar, fillor të mesëm të mlet dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

#### SHFMU " 28 Nëntori"- Bresanë

1. Një mësimdhënës për gjuhë shqipe ( 10 orë )

#### SHFMU " Fetah Sylejani " Dragash

1. Një mësimdhënës për gjuhë angleze ( 18 orë, deri sa punëtohet të kthehet nga pushimi pezullimi i përkohshëm ( dakorduar ) i marrëdhënës së punës )

#### SHFMU "Svetlost " Kruhëvë

1. Një mësimdhënës për mësim klasor

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të notorizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtet dhe informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrimin nuk tu kthehet kandidatëve.

Datë: 06.11.2020  
Dragash

Drejtori DKA së  
MSc. Vlloran Cenaj



## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gazmend Deda shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.T. "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë.
- Edonis Guci shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI te Sh>M.E. "Kadri Kusari" në 137 Gjakovë.
- Sevime Bela shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme SH.M.L "Dardania" Hani Elezit.
- "GM-Kosova" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810072257
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

